

Islami emanet në duart tona, çka nëse nuk e çojmë në vend

DIELLI LIND NË LINDJE
E
PERENDON NË PERENDIN
AS
NË LINDJE NUK KA SHKËLQIMIN E TIJ
SA
DUHET, E AS NË PERENDIM
POR
NXEHJA E TIJ MË E SHUMTË ËSHTË
KUR
AI GJENDET NË ZENIT, MES TË QIELLIT ¹

.....
Hamdi dhe falënderimi më i singertë qoftë për Krijuesin, Furnizuesin dhe Mëshiruesin tonë.

Salatet dhe selamet, faljet dhe mëshira qofshin përmbi të Dërguarin e Tij, Muhamedin a.s., drejtuesin e njerëzisë në rrugë të mbarë, mbi familjen e tij, shokët e tij dhe gjithë besimtarët në përgjithësi, të gjallë apo të vdekur qofshin.

Në këtë temë do të mund t'i qasemi fjalës EMANET (amanet) dhe kuptimit të saj. Do t'i japim një vështrim kësaj fjale dhe çfarë rëndësie i jep Islami emanetit.

Kjo fjalë rrjedh nga gjuha arabe e në kuptimin etimologjik do të thotë : "SIGURI", "BESË" etj., kurse në atë terminologjik do të thotë: "Diçka që jepet në besë për ta çuar në vendin e duhur. Kjo diçka mund të jetë fjalë, punë, rrobë apo e ndryshme. Thotë All-llahu xh.sh. : » **dhe çoni emanetin në vendin (te zotëria) e saj** ».

Shohim pra qartë, i nderuari vëlla, se All-llahu xh.sh. urdhëron prerë dhe në formë imperative për zbatimin e këtij urdhri fetar e moral.

Nëse ky emanet është një fjalë dhe kërkohet të mos tregohet fshehtësia, atëherë duhet marrë parasysh këtë dhe nëse e çon në vend por sekretin nuk është ruajtur, edhe ky urdhër nuk konsiderohet te Allahu si i plotësuar. Nëse ky emanet është një send apo e ngjashme, atëherë pos dërgimit në vend ka për obligim dërguesi edhe ruajtjen e saj dhe përkujdesjen sikur të ishte e vetja personale ndoshta edhe më tepër.

I nderuar, edhe Islami është një emanet për ata që e kanë krahas atyre që nuk e kanë e as që e kuptojnë.

Zbritja e Islamit në Mekke ishte një emanet për pranuesin e parë (Muhamedin a.s.) që ta përhapë dhe ta çojë në vend urdhrin e Shpallësit. Ai duhej ta përcillte këtë dritë edhe në konakët e atyre që nuk e kishin

¹ Poezia e Muhamed Ikbballit cekur në fillim të librit "Islami mes lindjes dhe perendimit" A. Izetbegovic

fare, pa marrë parasysh afërsinë dhe farefisninë, Mekke apo Medine, Hixhaz² apo vendet tjera arabe.

Më së miri na e argumenton këtë imperativ Allahu xh.sh. ku thotë: « **O Pejgamber prediko atë që të zbritet nga Zoti yt, e nëse nuk e bërë këtë, nuk e ke plotësuar urdhrin e Zotit tënd** ».

O ti i mbuluar, ke marrë mbi vete një emanet, ngrihu dhe zbatoje këtë emanet.

Shumë i qofshim falë Zotit që e obligoi Muhamedin a.s. për këtë punë madhështore se përndryshe as ti e as unë nuk do të ishim sot të udhëzuar e në fenë e Allahut duke besuar. Ai e la këtë emanet në duart e pasardhësve të tij dhe shokëve të palodhur për Islam të cilët gjeneratë pas gjenerate e sollën edhe deri te pragu i derës sate.

Tash çka mbetet me ne ?

Edhe neve sikur gjeneratave më të hershme na erdhi një përgjegjësi e madhe mbi supet dhe do të duhet patjetër ta vazhdojmë këtë punë të ndershme të Muhamedit dhe të peygambereve të tjerë, Allahu qoftë i kënaqur me ta krejt. Thotë Allahu dhul Xhelal :

إِنَّا عَرَضْنَا الْأَمَانَةَ عَلَى السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ وَالْجِبَالِ فَأَبَيْنَ أَنْ يَحْمِلْنَهَا وَأَشْفَقْنَ مِنْهَا وَحَمَلَهَا الْإِنْسَانُ إِنَّهُ كَانَ ظَلُومًا جَهُولًا

« Ne u ofruam emanetin (obligimet) qiejve, tokës dhe maleve, e ato nuk deshën ta marrin përsipër atë u frikësuan prej tij, ndërsa njeriu atë e mori mbi vete; dhe ai i bëri padrejtësi vetvetes, dhe ishte i padijshëm. »³

Ku ta dërgojmë këtë?

Te gjeneratat e reja që lindin dhe pas ushqimit të përditshëm trupor fillojnë dalëngadalë të kërkojnë edhe ushqimin shpirtëror. Atë duhet ta gjejnë diku, e ku je ti i nderuar vëlla besimtar?! Nëse këtë ti nuk do të mund t`ia dalësh ta nxjerrësh në dritë, këtë ka për ta bërë dashamiri i tagutit³, i cili vjen dhe nga drita e nxjerr në terr.

Çka bëhet nëse nuk do ta çojmë emanetin në vend ?

Le të marrim edhe diçka për njohje, nëse dikush nga njerëzit dhe xhinët nuk e kryen urdhrin e Allahut, kjo nuk do të thotë, i nderuar, se Atij xh. sh. i është pakësuar diçka nga sundimi apo është pakësuar nga Qenia e Tij absolute. Atij i takojnë gjithë çka ka në qiell, tokë dhe mes tyre, Atë e lavdëron gjithçka, i lartësuar qoftë Krijuesi, Furnizuesi ynë.

A thua vallë do të përfundojë Islami në atë vend ?

Allahu xh. sh. e ka lënë mbi ne këtë emanet, por e ka njohur mirë krijesën e Tij dhe mu për këtë shkak ruajtjen dhe kujdesin nga humbja e

² Hixhaz quhej Arabia Saudite e sodit.

³ Suretul Ahzab:72.

⁴ Tagut quhet shejtani i mallkuar siç e përshkruan Allahu në Kur`an.

shkatërrimi i Islamit e morri Vetë në sigurim duke thënë : « Ne e zbritëm shpalljen dhe Ne do ta ruajmë atë » .

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا مَنْ يَرْتَدَّ مِنْكُمْ عَنْ دِينِهِ فَسَوْفَ يَأْتِي اللَّهَ بِقَوْمٍ يُحِبُّهُمْ وَيُحِبُّونَهُ أَذِلَّةٍ عَلَى الْمُؤْمِنِينَ أَعِزَّةٍ عَلَى الْكَافِرِينَ يُجَاهِدُونَ فِي سَبِيلِ اللَّهِ وَلَا يَخَافُونَ لَوْمَةَ لَائِمٍ ذَلِكَ فَضْلُ اللَّهِ يُؤْتِيهِ مَنْ يَشَاءُ وَاللَّهُ وَاسِعٌ عَلِيمٌ

„O ju që besuat! Kush largohet nga feja e vetë (i bën dëm vetes) s’ka dyshim se All-llahu do të sjellë një popull që Ai e do atë (popull) dhe ata e duan Atë (Zotin),(një popull) që është modest e i butë ndaj besimtarëve, por i ashpër dhe i fortë ndaj mohuesve, që lufton në rrugën e All-llahut dhe që nuk i frikësohet kërcënimit të asnjë kërcënuesi. Kjo (cilësi e atij populli) është dhuratë e All-llahut që i jep atij që do. All-llahu është dhurues i madh, i dijshtëm.“⁵

Kush mund të jetë ky popull tjetër?

Në poezinë e lartëcituar shkrintari thotë: Islami lindi në lindje dhe do të ngjitet kah perëndimi, po as në lindje nuk e ka shkëlqimin e tij të mjaftueshëm e as në perëndimin e largët, por fuqinë e tij më të madhe do ta ketë kur ai është në mes (Zenit).

A thua vallë mund të jenë këta popuj evropianët?

A shihni o njerëz sa me të madhe janë kah e pranojnë islamin evropianët? A i shihni punët e evropianëve dhe punët e muslimanëve, cilët janë më të drejta dhe reale?

A është më lehtë të mësosh diçka në teori e pastaj ta zbatosh atë në praktikë apo të zbatohet në praktikë e diçka më vonë të mësohet në teori. A është më mirë të dish diçka e të mos e praktikosh apo ta praktikosh?

Nëse i shohim punët e muslimanëve dhe të jomuslimanëve do të shohim se cilët i përshtaten më së shumti islamit. Cilët janë ata që më së shumti gënjejnë, tradhtojnë, dhe kryejnë vëllavrasje?

Në Gjermani jetojnë rreth 450 000 gjermanë vendas që e kanë pranuar Islamin dhe jetojnë me krenari si muslimanë e janë më praktikues të Islamit se vetë muslimanët e lindur!

Të lutem ndihmomë pak dhe mendo bashkë me mua se a është e vërtetë kjo? A je i informuar se në Gjermani ka më tepër se 2000 xhami që një numër bukur i madh i tyre janë me minare? A e di se lëvizja islame në Angli dhe Francë janë shumëfish më aktive se në Gjermani? Të kujtohet ndoshta që para 10 deri më 15 vite në Zvicër duhej të kujtohesh gjatë ku do ta falësh namazin e Bajramit, kurse sot xhamitë e muslimanëve në Zvicër arrijnë në mbi 500! Diku rreth 49 000 është numri i zvicëranëve që e kanë pranuar Islamin.

⁵ Suretul Maide 54.

Kush është ai që i bindi këta njerëz? A ishim unë dhe ti, i nderuar vëlla, që vraponim shtëpi në shtëpi për ti bindur këta në Islam?

Ky është vetëm Allahu një me fuqinë dhe lartmadhërinë e Tij! Të cekim disa dijetarë evropianë se çka thanë për Islamin dhe Muhamedin a.s.!

Bernard Shaw:

Në kohën e tashme po shihet se shumë evropianë tanë po hyjnë në Islam. Mund të thuhet se kthimi i Evropës kah Islami vetëm se ka filluar.

Otto von Bizmark:

„Muhamed, më vjen keq që nuk kam qenë bashkëkohësi, as'habi yt“.

Tolstoi:

“Nuk ka dyshim se feja e Muhamedit dhe ai janë reformatorët më të mëdhenj në botë, të cilët njerëzit i udhëzuan në të vërtetë dhe dritë“.

وإِذْ يَمْكُرُ بِكَ الَّذِينَ كَفَرُوا لِيُبْنِيَنَّوْكَ أَوْ يُقْتُلُوْكَ أَوْ يُخْرِجُوْكَ ۗ وَيَمْكُرُونَ وَيَمْكُرُ اللَّهُ وَاللَّهُ خَيْرٌ
الْمَاكِرِينَ

Edhe ata planifikojnë po edhe Allahu planifikon, por planet e Allahut janë më të mirat e gjithmonë ecin përpara. Përkujto (o i dërguar) kur ata që nuk besuan thurnin plane kundër teje: të të ngujojnë, të të mbysin ose të të dëbojnë. Ata bënë plane, e All-llahu është më i miri që asgjëson (dredhitë).⁷

Përgatiti:
mr. Bekim Alimi,
Imam në Wil, Zvicër

⁶ El Enfal :30.